



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 301/11 Prot.

Tiranë, më 22.09.2025

V E N D I M

Nr. 217, Datë 22.09.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 40, datë 17.02.2025, e bërë nga znj. E.Th kundër Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK) (Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “gjinisë¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesja në mes të tjerash informon se: “Jam producente dhe regjisore për filma të animuar. QKK, hapi thirrjet për projekte në datën 27.11.2024, në disa kategori, ndër të cilat edhe për filma të animuar. Aplikova konform dokumentacionit të përcaktuar në Rregullore dhe në datën 10.12.2024, njoftohem me email për vendimin e Komisionit të Shqyrtimit Paraprak të Projekteve, se në bazë të Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, nr. 168, datë 27.05.2024, rezulton se projekti “Legjenda e vllamaleve”, aplikuar nga shtëpia

¹ Shkak i pretenduar gjatë seancës dëgjimore datë 20.05.2025.

kinematografike “Agim Production”, ku unë jam përfaqësuese ligjore, nuk përmbush kriteret e detyrueshme për kualifikim në kategorinë për “Film të animuar”, për arsye se regjisor i projektit duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia dhe të ketë punuar së paku në dy filma të animuar si asistent pas studimeve.

Projekti nuk u kualifikua në konkurrim për shkak të diplomës time, “Regji Teatri dhe Spektakli”.

Në dokumentacionin e dosjes kam paraqitur diplomën dhe listën e notave, ku tregohen lëndët e filmit që kam studiuar dhe jam vlerësuar me nota të larta. Diploma ime Master është për Regji Teatri dhe Spektakli, të cilat janë pjesë e Multimedias që lejohet në Rregullore. Në të dy vitet e Masterit kam bërë lëndën Regji Filmi dhe Televizioni dhe jam vlerësuar me nota të larta.

Në rregullore gjithashtu parashikohet që regjisor i duhet të ketë punuar së paku në dy filma të animuar si asistent pas studimeve.

Mendoj se e plotësoj dhe tejkaloj edhe kriterin e dytë, pasi në cilësinë e regjisoresh kam marrë mbështetje nga QKK për realizimin e dy filmave të animuar: - Legjenda e Vendit t’shenjtë. - Legjenda e Argjiros.

Të dy këta filma janë shpërndarë me sukses brenda vendit nëpërmjet Open Cinema që zhvillohet çdo vit nëpër qytete të ndryshme, si dhe jashtë vendit, duke u bërë pjesë e kurrikulës mësimore për fëmijët shqiptarë jashtë atdheut.

Formimi universitar, si dhe eksperiencia ime si Regjisore në realizimin e dy filmave, janë të mjaftueshme për të më dhënë mundësinë që të vazhdoj konkurrimin, si një e drejtë themelore.

Diskriminime të tilla të përcaktuara në Rregullore, bëhen mbi bazë konflikti interesi, kur dihet që Kryetari i QKK, deri pak muaj më parë ka qenë pjesë e Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi. Kriteri diskriminues është subjektiv, që përjashton një gjeneratë regjisoresh (35-45 vjeç) që janë në kulmin e krijimtarisë. I kam drejtuar kryetarit të QKK, disa ankesa nga të cilat vetëm për njërin kam marrë përgjigje zyrtare me shkrim.

Kam konstatuar se në të njëjtën periudhë që unë dhe disa regjisorë të tjerë jemi skualifikuar nga gara për arsye të diplomës, ka pasur edhe regjisorë që nuk e kanë paraqitur diplomën dhe janë kualifikuar në garë, madje dhe janë shpallur fitues.

Kërkoj konstatimin e diskriminimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë për diplomat regji filmi, pasi është diskriminim që i bëhet një kategorie regjisorësh që kanë marrë më parë financim nga QKK, duke i hequr të drejtën e konkurimit për realizimin e veprave kinematografike. Në kohën kur unë kam studiuar nuk ka patur degë regji filmi, por vetëm regji teatri. Ky është diskriminim i hapur dhe kufizim i lirisë së krijimtarisë, e drejtë e sanksionuar me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve të QKK, në të cilën kërkohet që regjisori të ketë përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar (në vijim LMD), parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 301/2, datë 24.02.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga QKK, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Cila është arsyeja për vendosjen e kriterit, që Regjisori i projektit të ketë përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi, pra cili është qëllimi që synon të arrijë QKK, nëpërmjet vendosjes së një kriteri të tillë?
 - Ku është bazuar vendimarrja për vendosjen e kriterit, që Regjisori i projektit të ketë përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi, për të konkuruar për të përfituar mbështetje financiare për projektet kinematografike? Cilat janë arsyet se përse një person

me diplomë Regji Teatri dhe Spektakli, nuk mund të jetë i aftë për të kryer detyrën e Regjisorit për projekte të ndryshme kinematografike?

- Informacion nëse ankuesja ka fituar mbështetje financiare për projektet e saj në vitet e kaluara. Nëse po, kopje të aktit/dokumentit provues.
- Kopje të plotë të vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit Paraprak të Projekteve, lidhur me aplikimin e ankueses, sipas thirrjes së datës 27.11.2024.
- Informacion nëse ka dhe regjisorë të tjerë që i janë kthyer për plotësim projektet (viti 2024) për arsye të mosplotësimit të kriterit: Të ketë përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi. Kopje të dokumentacionit nëse ka.
- Kopje të plotë të ankesave të bëra nga znj. Th dhe përgjigjeve të dhëna nga institucioni.
- Kopje të Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve të QKK, të vitit 2023.
- Kopje të Rregullores së Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve nr. 168, datë 27.05.2024.
- Informacion për periudhën se kur janë diplomuar për herë të parë studentët në Universitetin e Arteve, në degën Regji Filmi.
- Informacion për periudhën se kur janë diplomuar për herë të parë studentët në Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi, në degën Regji Filmi?

Me shkresën nr. 26/3, datë 11.03.2025, QKK, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Kriteri i arsimit është objektiv dhe i nevojshëm për cilësinë e projekteve, sipas Rregullores nr. 168, datë 27.05.2024 (Kreu V, nënpika 5) ku, për projektet e animuara kërkohet një diplomë e specializuar në Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia. Ky kriter bazohet në nevojën për aftësi specifike teknike dhe artistike si, njohuri për animacionin. Regjisorët e filmit dhe artistët figurativë trajnohen për të ndërtuar rrëfimin përmes kuadrove, planeve dhe montazhit, ndërsa regjisorët e teatrit bazohen te interpretimi në skenë dhe mizanskena skenike. Teknologjia është thelbësore në animacion – përdorimi i softuerëve të specializuar për animacion është pjesë e formimit të regjisorëve të filmit dhe artistëve figurativë, por jo e regjisorëve të teatrit. Në animacion nuk ka aktorë fizikë apo skenë reale: gjithçka duhet të konceptohet dhe krijohet vizualisht nga e para.*

Koha dhe ritmi në animacion ndërtohen përmes montazhit dhe përpunimit të imazhit, ndërsa në teatër rrjedhin në mënyrë lineare përmes interpretimit në skenë. Për këtë arsye, kriteri i diplomës në Regji Filmi ose Arte Figurative&Multimediale nuk është diskriminues, por një standard profesional i domosdoshëm për të garantuar cilësinë e projekteve të animuara. Sipas nenit 6, pika 2, të Ligjit 10221/2010, të LMD, të ndryshuar, “Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që, qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj”.

Kriteri për diplomë në Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia është vendosur për të garantuar cilësinë profesionale të projekteve të animuara dhe zbatohet njësoj për të gjithë aplikantët. Për këtë arsye, mungesa e këtij kualifikimi formal të znj. Th, justifikon refuzimin e aplikimit të saj, në përputhje me kërkesat e qarta të rregullores.

Zbatimi i barabartë i kriterëve të rregullores përjashton çdo pretendim për diskriminim. QKK-ja ka aplikuar kriterin e arsimimit në mënyrë konsistente dhe të drejtë për të gjithë aplikantët në thirrjen e vitit 2024. Disa aplikime të tjera janë refuzuar për të njëjtën arsye - mungesën e diplomës së kërkuar - çka tregon mungesën e trajtimit të pabarabartë ose paragjykimin ndaj znj. Th. Mbështetja e mëparshme për dy projekte të saj dëshmon se QKK-ja nuk ka pasur asnjë qëllim për ta përjashtuar atë në bazë personale. Vendimi për refuzimin e këtij aplikimi u mor bazuar vetëm në rregulloren në fuqi, duke respektuar standardet e njëjta për të gjithë.

Përvoja e znj. Th nuk zëvendëson dot kualifikimin formal në këtë rast. QKK-ja ka marrë në konsideratë përvojën e znj. Th me dy filma të animuar të financuar më parë dhe ka lënë një mundësi të hapur për krijuesit pa kualifikim formal, përmes klauzolës së përjashtimit në Rregulloren nr. 168, kreu V, nënpika 5.d. Sipas kësaj klauzole, një regjisor që nuk plotëson kriterin e arsimimit mund të kualifikohet nëse ka realizuar një film të animuar me fonde të pavarura ose me financimin e QKK-së, i cili të jetë kualifikuar në konkurrim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreun II / A.1.2, nënpika 11, të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK-së. Kjo dritare është krijuar pikërisht për të njohur përvojën profesionale si zëvendësuese e kualifikimit formal, duke treguar fleksibilitetin dhe drejtësinë e QKK-së në politikën e saj. Znj. Th ka pasur mundësinë të demonstrojë aftësitë e saj me dy filmat e saj të mëparshëm, por ajo nuk ka paraqitur dëshmi që këta filma të jenë kualifikuar në festivalet e specifikuar ose të kenë pasur një qarkullim zyrtar të suksesshëm me shitje biletash të dokumentuara. Për pasojë, përvoja e saj, ndonëse e vlerësuar, nuk arrin prapenjë të përcaktuar nga rregullorja për të zëvendësuar trajnimin formal, çka e bën refuzimin të bazuar dhe jo diskriminues.

QKK-ja është e hapur për dialog, por standardet nuk mund të komprometohen. QKK-ja shpreh gatishmërinë për të dëgjuar shqetësimet e znj. Th dhe për të rishikuar rregulloren në të ardhmen, nëse kjo gjykohet e nevojshme. Megjithatë, kriteri aktual është i pazëvendësueshëm për momentin, pasi garanton që projektet e financuara të jenë në nivelin e duhur profesional dhe artistik, duke përmbushur përgjegjësinë e QKK-së për të administruar fondet shtetërore me efikasitet dhe transparencë.

Pretendimi i znj. Th për diskriminim nuk ka bazë, pasi refuzimi i aplikimit të saj buron nga një kriter objektiv, legjitim dhe i zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë. QKK-ja nuk ka pasur qëllim diskriminues, por ka ndjekur një standard të nevojshëm për të mbrojtur cilësinë e kinemasë dhe interesin publik. Vendimi është i drejtë dhe i mirë arsyetuar, dhe ne ftojmë znj. Th për dialog konstruktiv për të adresuar çdo shqetësim të mëtejshëm.

- *Arsyeja për vendosjen e kriterit të arsimimit.*

Kriteri i arsimimit është vendosur për të garantuar cilësinë dhe profesionalizmin e projekteve të financuara nga QKK-ja. Filmat e animuar kërkojnë njohuri specifike teknike dhe artistike – si animacion softuerë për dizajn dhe estetikë vizuale të cilat ofrohen nga programet e dedikuara të Regjisë së Filmit ose Arteve Figurative dhe Multimedia. Kjo kërkesë mbron interesin publik dhe siguron përdorim eficient të fondeve shtetërore.

QKK e Shqipërisë aplikon kritere të ngjashme me ato të qendrave ndërkombëtare si CNC e Francës, FÇG e Malit të Zi, GFC e Greqisë dhe HAVC e Kroacisë, të cilat kërkojnë trajnim formal (p.sh. diplomë në Regji Filmi ose Arte Vizuale) ose sukses të dëshmuar në festivale dhe projekte për animacionin. QKK-ja, në përputhje me këto standarde, ofron mundësinë e përjashtimit nga kërkesa për diplomë për aplikantët me arritje të njohura.

- *Baza e vendimmarrjes dhe arsyeja pse diploma në Regji Teatri dhe Spektakli nuk konsiderohet e mjaftueshme.*

Vendimi bazohet në Rregulloren nr. 168, datë 27.05.2024 (kreu V, nënpika 5), e cila është në përputhje me Ligjin nr. 8096 “Për Kinematografinë”. Një diplomë në Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia ofron trajnim të specializuar për kinematografi, montazh dhe efekte vizuale, të cilat nuk mbulohen nga Regjia e Teatrit dhe Spektaklit, e fokusuar më tepër te performanca skenike.

- *Informacion mbi mbështetjen financiare të mëparshme për znj. Th.*

Znj. Th ka përfituar financim për dy projekte të mëparshme: “Legjenda e Vendit t’shenjtë” dhe “Legjenda e Argjiros”. Megjithatë, çdo aplikim vlerësohet sipas rregullores në fuqi në kohën e aplikimit.

- *Kopje e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit Paraprak.*

Vendimi i Komisionit për refuzimin e projektit “Legjenda e vllamaleve” është bashkëngjitur dhe tregon se, arsyeja e vetme e refuzimit ishte mungesa e diplomës së kërkuar sipas rregullores.

- *Informacion mbi aplikime të tjera të refuzuara.*

Gjatë thirrjes së vitit 2024, 4 (katër) aplikime të tjera u refuzuan për mungesë të diplomës së kërkuar, duke konfirmuar zbatimin e barabartë dhe të paanshëm të rregullores për të gjithë aplikantët.

- *Informacion mbi diplomat e Regjisë së Filmit.*

Studentët e parë në Regji Filmi janë diplomuar në vitin 2009, sipas të dhënave nga Universiteti i Arteve dhe Akademia Marubi 2007, duke ofruar kontekst mbi disponueshmërinë e këtij trajnimi të specializuar.

Përfundimi:

QKK konfirmon se vendimi për refuzimin e aplikimit të znj. E.Th është marrë në përputhje të plotë me rregulloren dhe ligjin, duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës. Ky vendim nuk ka pasur asnjë qëllim diskriminues, por është bazuar në standardet profesionale të kërkuara për projektet e animuara.

Mbetemi të hapur për dialog, por standardet e cilësisë dhe profesionalizmit janë thelbësore për të garantuar përdorimin e drejtë të fondeve publike dhe për të nxitur zhvillimin e industrisë kinematografike kombëtare. Në përputhje me rregulloren në fuqi, mungesa e këtij kualifikimi formal përbën një arsye të ligjshme për refuzimin e aplikimit të saj.

Theksojmë se, kriteri i përcaktuar nuk synon të përjashtojë, por të ndërtojë një komunitet të fortë profesionistësh në fushën e animacionit, duke krijuar mundësi për bashkëpunim dhe ndarjen e potencialeve mes krijuesve të kualifikuar. QKK mbetet e angazhuar për të mbështetur projekte që përmbushin standardet më të larta artistike dhe teknike, duke siguruar që fondet publike të investohen në vepra me ndikim dhe vlerë të qëndrueshme për kinemanë shqiptare”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 19.03.2025, është njohur me përgjigjen e QKK-së.

Në përgjigje të informacionit të dërguar nga QKK-ja, ankuesja me email-in datë 27.03.2025 dhe me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 301/4, datë 14.04.2025, ka kundërshtuar përgjigjen e dhënë nga QKK duke parashtruar në mes të tjerash se:

“Nuk është e vërtetë që kriteri i arsimit është objektiv dhe i nevojshëm për cilësinë e projekteve. Vendosja e kriterit të diplomës në Regji Filmi, ose Arte Figurative dhe Multimedia për projektet e animuara është tejkalim i kompetencave, deri në abuzim me detyrën.

Është e vërtetë që filmi i animuar kërkon njohuri specifike, por nuk është e vërtetë që artistët figurativë trajnohen për të ndërtuar rrëfimin përmes kuadrove, planit dhe montazhit. Artistët figurativë janë piktorët dhe skulptorët, të cilët në formimin bazë profesional nuk marrin njohuri, apo trajnohen “për të ndërtuar rrëfimin përmes kuadrove, planit dhe montazhit”. Ndërkohë që unë në masterin shkencor kam bërë lëndë të filmit, ku kam mësuar punën me aktorët dhe teknikat e tjera që përdoren për realizimin e filmit.

Nuk është e vërtetë që për filmin e animuar, ashtu si për çdo film tjetër regjisorit duhet të dijë të përdorë dhe zotërojë përdorimin e softverëve. Filmi është një punë në grup, ku çdo profesion ka specialistin e vet.

Përfaqësuesja që ka nënshkruar përgjigjen e QKK ka vetëm 2 muaj në atë detyrë dhe nuk e ka aftësinë profesionale që të japë argumente lidhur me këtë çështje. Për më tepër përfaqësuesja e QKK nuk e ka fare idenë që projektet e mia filmike realizohen me metodën ROTOSKOP, (<https://dbpedia.org/page/Rotoscoping>) ku xhirimi kryhet me aktorë realë dhe më pas vijohet me punën e ngjyrosjes së personazheve dhe proceseve të tjera të filmit të animuar.

- Diskriminimi i drejtpërdrejtë: kur një person trajtohet më keq se një tjetër në situatë të ngjashme.

Lidhur me këtë pikë, duhet të theksoj se për herë të parë në historinë e institucionit (QKK) është vënë kriteri i diplomës Regji Filmi për çdo kategori projekti filmik. Para vitit 2023, kriteri për diplomën Regji Filmi, ka qenë vetëm për filmat artistikë me metrazh të shkurtër.

Përfundimi im nga gara është bërë në mënyrë të padrejtë, kur një aplikant tjetër, në kategorinë pasprodhim dhe distribucion nuk ka paraqitur diplomën dhe është kualifikuar në konkurrim, madje edhe është financuar për projektin e tij. Për këtë ju kam paraqitur Procesverbalin e KSHPP nr. 437/8, datë 6.12.2024.

Në këtë mënyrë më është cenuar një nga të drejtat themelore të njeriut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut- E drejta për barazi përpara ligjit - Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë. Fakti është kokëfortë dhe i thjeshtë:

- Unë u skualifikova edhe pse dorëzoja në aplikim diplomën time Master Shkencor “Regji Teatri dhe Spektakli”.
- Zotëria, i cili nuk dorëzoi një prej dokumenteve të detyrueshme, jo vetëm që nuk u s’kualifikua, por u shpall fitues dhe u financua.

Rregulli i diplomës diskriminon një brez të tërë regjisorësh, të cilët kanë përfunduar studimet në periudhën para vitit 2007, siç jam unë dhe shumë bashkëkohës të mi, pa u marrë në konsideratë se kemi realizuar filma me mbështetjen e QKK. Mendoj se ky kriter është vendosur për t’i dhënë lëndë të parë (studentë potencialë) një shkolle, e cila, megjithë financimet që i bëhen çdo vit nga buxheti i shtetit, është në prag të falimentimit dhe aktualisht është në proces për të hapur studime Master për Regji Filmi. Drejtuesit e QKK-së, përfshi edhe zonjën që ka nënshkruar përgjigjen e QKK-së kanë interesa private me këtë shkollë.

Unë, si një përfaqësuese e brezit tim, që nuk patëm mundësinë të studionim për Regji Filmi dhe TV, pasi nuk ekzistonte një degë e tillë, megjithë pasionin që mund të kishim për kinematografinë, nuk kërkoj asgjë më shumë sesa të më jepet e drejta për t’u pranuar në konkurrim. Në rast se projekti që paraqes në konkurrim është i dobët, ai nuk do të renditet tek projektet fituese që marrin mbështetje financiare.

Diploma që unë disponoj është Regji Teatri dhe Spektakli, titulli që unë kam është Regjisore dhe jo diplomë për inxhinieri, arkitekturë, fizikë, apo diçka tjetër. Disponimi ose jo i diplomës në mënyrë eksplicite për Regji Filmi, në fund të fundit është rrisht i regjisorit. Në rast se filmi paraardhës nuk ka qenë në nivel artistik, ose projekti në konkurrim nuk është premtues, Këshilli i Miratimit të Projekteve, i cili përbëhet nga specialistë të fushës, personalitete të kinematografisë dhe audiovizualit, nuk do ta vlerësojë dhe nuk do ta financojë projektin.

Pra, projekti që aplikohet kalon nëpër gjykimin dhe vlerësimin profesional të ekspertëve të filmit dhe është e palogjikshme që të privohet nga e drejta e konkurimit, për një rregull absurd të vendosur nga një, apo disa burokratë të QKK.

Gjithashtu, projektet vlerësohen me fletë votimi ku marrin vlerësim me pikë edhe projekti i mëparshëm edhe projekti që aplikohet.

Ashtu siç e thashë edhe më sipër, rregulli i diplomës për të gjitha kategoritë është vendosur për herë të parë në Rregulloren e miratuar në Maj 2024. Madje, situata është agravuar edhe më tej në rregulloren e Janarit 2025. Në këtë të fundit, regjisorët jo vetëm që duhet të kenë mbaruar në degën Regji Filmi, por, që të kenë të drejtë për të aplikuar, duhet të kenë punuar edhe në dy filma si asistentë regjie në projekte kinematografike dhe audiovizuale të financuara nga QKK pas diplomimit.

Përfaqësuesja e QKK-së gënjen kur shprehet se: “QKK e Shqipërisë aplikon kritere të ngjashme me ato të qendrave ndërkombëtare si CNC e Francës, FCCG e Malit të Zi, GFC e Greqisë dhe HAVC e Kroacisë, të cilët kërkojnë trajnim formal për (psh. Diplomë në regji filmi dhe arte vizuale) ose sukses të dëshmuar në festivale dhe projekte për animacion”.

Aq e rëndësishme është diploma Regji Filmi për përfaqësuesen e QKK-së, saqë e barazon me një “trajnim formal”!!! Në qendrat homologe që përmend përfaqësuesja e QKK-së nuk eksiztojnë këto rregulla për diplomën e regjisë së filmit.

Roli i regjisorit në një projekt filmik është thelbësor dhe shumëdimensional. Regjisori është udhëheqësi artistik dhe krijues i filmit që merr përgjegjësinë për shndërrimin e skenarit në një vepër vizuale. Ja disa aspekte kryesore të rolit të regjisorit:

- a. Interpretimi i skenarit - Regjisori analizon dhe interpreton skenarin, duke përcaktuar vizionin artistik dhe tonin e filmit.*
- b. Udhëheqja e aktorëve - Regjisori punon ngushtë me aktorët, duke i drejtuar ata në interpretimin e personazheve, emocionet, dhe lëvizjet që duhet të shfaqin.*
- c. Bashkëpunimi me ekipin teknik - Regjisori komunikon vizionin e tij me drejtorin e fotografisë, skenografin, kostumografin, kompozitorin dhe të gjithë ekipin teknik.*
- d. Vendimmarrja për xhirimet - Regjisori vendos për këndet e kamerave, lëvizjet, ndriçimin, dhe të gjitha aspektet vizuale që do të përcjellin historinë.*
- e. Mbikëqyrja e montazhit - Regjisori punon ngushtë me montazhierin për të përzgjedhur dhe organizuar skenat e xhiruara në mënyrën që i shërben më mirë rrëfimit.*
- f. Menaxhimi i projektit - Regjisori duhet të sigurohet që filmi të përfundojë brenda afateve dhe buxhetit të përcaktuar.*
- g. Ruajtja e koherencës artistike - Regjisori siguron që të gjitha elementet e filmit të punojnë së bashku për të krijuar një vepër të unifikuar.*

Të gjitha këto aftësi unë i disponoj më së miri, pasi e kam titullin Regjisorë dhe kjo dëshmohet me dy filmat e animuar që kam realizuar me financimin e QKK-së. Këto filma në bashkëpunim me Ambasadën Shqiptare në Zagreb do të futen në kurrikulën e shkollave fillore për pakicat shqiptare në Kroaci.

- *Regjisorë të suksesshëm që kanë korrur suksese pa qenë të diplomuar për regji filmi: Quentin Tarantino; Christopher Nolan; Steven Spielberg; James Cameron; Woody Allen; Stanley Kubrick; etj”.*

Me shkresën të protokolluar me tonën me nr. 301/5, datë 05.05.2025, ankuesja ka informuar se: *“Lidhur me ankesën që kam bërë pranë institucionit, mbetem në pritje të vendimmarrjes dhe njëherësh ju bëj me dije se në datën 30.04.2025, QKK ka hapur thirrje për projekte për film të animuar. Thirrja për këtë kategori projektesh hapet vetëm një herë në vit dhe është e vlefshme deri në datën 29.05.2025”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 301/6, datë 12.05.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 20.05.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua në datën e caktuar, me praninë e palëve: subjektit ankues znj. E.Th dhe përfaqësueses² së QKK.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor, formularit të ankesës së dorëzuar gjatë seancës, si dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Jam me profesion producentë dhe regjisorë për filma të animuar. QKK ka parashikuar që nëse nuk përmbush kriterin e studimeve, nuk përfiton nga buxheti i këtij institucioni. Në dokumentacionin e dosjes kam paraqitur diplomën dhe listën e notave, ku tregohen lëndët e filmit që kam studiuar dhe jam vlerësuar me nota të larta. Diploma ime master është për Regji Teatri dhe Spektakli, të cilat janë pjesë e multimedias që lejohet në rregullore. Në dy vitet e masterit kam bërë lëndën Regji Filmi dhe Televizioni dhe jam vlerësuar me nota të larta.*

Në rregullore gjithashtu parashikohet që regjisori duhet të ketë punuar së paku në dy filma të animuar si asistent pas studimeve. Mendoj se e plotësoj dhe tejkaloj edhe kriterin e dytë, pasi në cilësinë e regjisorës kam marrë mbështetje nga QKK për realizimin e dy filmave të animuar. Të dy këto filma janë shpërndarë me sukses brenda vendit nëpërmjet aktivitetit Open Cinema që

² Shtetases R.D, me pozicionin specialiste juriste, me autorizim nr. 303, datë 14.05.2025.

zhvillohet çdo vit nëpër qytete të ndryshme, si dhe jashtë vendit duke u bërë pjesë e kurrikulës mësimore për fëmijët shqiptarë jashtë atdheut.

Kam konstatuar se në të njëjtën periudhë që unë dhe disa regjisorë të tjerë jemi skualifikuar nga gara për arsye të diplomës, ka pasur regjisor (E.T) që nuk kanë paraqitur diplomën dhe nuk është skualifikuar nga gara dhe është shpallur fitues. Unë mendoj se jam diskriminuar padrejtësisht për shkak të formimit tim arsimor dhe prej të qenit grua”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e QKK, i qëndroi të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe në mes të tjerash deklaroi se: *“Sipas ligjit për kinematografinë, Kryetari i QKK ka diskrecionin për miratimin e rregullores. Rregullorja e re (27.05.2024) parashikoi ndryshime në lidhje me specifikimet e regjisorit. Në rregulloren e vitit 2023, nuk ka pasur kritere për diplomën. Për këtë projekt u vendos ky kriter për aftësitë specifike teknike të regjisorit, por dhe artistike, si njohuri për animacionin. Nuk bëhet fjalë për dy lëndë, por për një formim të përgjithshëm në Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia, pasi bëhet fjalë për shpërndarje fondesh publike, ndaj do bëhet një përzgjedhje e tillë për të patur projekte të suksesshme. Cilësinë dhe suksesin e kemi analizuar në bazë të filmave të mëparshëm. Filmi i fundit i paraqitur nga znj. Th, ka qenë i financuar nga QKK.*

Rregullorja e re ka parashikuar se për të gjithë ato persona që nuk e plotësojnë kriterin e diplomës, të ketë dhe një kriter tjetër që të vërtetojë që një projekt i mëparshëm të cilin e kanë financuar me fonde të pararura apo një projekt homolog shqiptar apo i huaj i financuar me fonde publike dhe të vërtetojë që ka marrë pjesë në një nga kategoritë e festivaleve të parashikuara në pikën “d” të rregullores.

Kriteret e diplomës dhe eksperiencës janë kumulativë. Kriteri i parë është ai arsimor dhe tjetri lidhet me eksperiencën. Kriteri nuk hedh poshtë punën e asnjë kineasti, por bëhet fjalë për shpërndarje sa më të drejtë të fondeve publike.

Projekti Open Cinema është projekt privat dhe QKK nuk e ka për detyrë për të selektuar filmat për këtë projekt.

Indicia për ndryshime në rregullore vjen dhe nga praktika të institucioneve analoge. Aktualisht rregullorja është ndryshuar përsëri, sepse ndryshimet janë në diskrecion të drejtorit. Sa i takon cilësisë së projekteve, njësia matëse tani është distribucioni.

Z. E.T i përket brezit që ka mbaruar për regji filmi dhe ky brez atashohej detyrimisht nga shkolla si asistent regjisor. Z. T ka sjellë vërtetim nga ministria përkatëse, sepse i përket një brezi që janë djegur regjistrat. Ndaj është futur si kriter eksperiencia, për të mos përjashtuar personat që kanë kontribuar në kinematografinë shqiptare”.

Me shkresën nr. 301/8, datë 31.07.2025, Komisioneri kërkoi nga QKK, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore. QKK nuk dërgoi përgjigje.

Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 301/9, datë 03.09.2025, znj. Th ka dërguar Suplimentin e Diplomës datë 20.09.2013, të lëshuar nga Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Subjekti ankues në ankesën objekt shqyrtimi ka pretenduar diskriminim nga ana e Komisionit të Shqyrtimit Paraprak të Projekteve të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë për skualifikimin e projektit të saj për film të animuar “Legjenda e vllamaleve”, të paraqitur në datë 05.12.2024, për shkak se nuk ka diplomë të studimeve për Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Referuar dokumentacionit kryesor të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar diplomës nr. 0010162, numër amze: AA214B000003, datë 20.09.2013, të lëshuar nga Universiteti i Arteve, rezulton se znj. E.Th zotëron Diplomë Universitare Master i Arteve të Bukura në Regji Teatri dhe Spektakli.

Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografi”, i ndryshuar, në nenin 3, ka parashikuar se: *“Qendra Kombëtare e Kinematografisë vepron si person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për bashkërendimin e punës, mbështetjen financiare, nxitjen e veprimtarisë kinematografike në Republikën e Shqipërisë dhe për përfaqësimin e kinematografisë shqiptare në botë.*

Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Rregullorja e funksionimit të QKK-së miratohet nga Kryetari i kësaj Qendre”.

Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohet se: *“QKK ka këto detyra kryesore: 1. 2. Shpërndan fondin për projektet që përmbushin kërkesat e rregullores për prodhimin dhe shpërndarjen e filmit dhe që kanë vlera cilësore dhe interes kulturor kombëtar, gjithashtu raporton për realizimin e projekteve dhe fondeve të miratuara”,* ndërsa në nenin 13, përcaktohet se: *“Përbërja dhe funksionimi i këshillave miratuese të projekteve e komisionit të vizionimit dhe e komisionit financiar përcaktohen në rregulloren e QKK”.*

Me VKM-në nr. 602, datë 21.08.2003, të ndryshuar, është miratuar Statuti i Qendrës Kombëtare Kinematografike. Në këtë Statut parashikohet se: *“Neni 3, pika 3: Në funksion të përmbushjes së kompetencave dhe atributëve që ajo ka në zbatim të ligjit, QKK plotëson detyrat e mëposhtme: 3. Shpërndan fondin për projektet që përmbushin kërkesat e rregullores për prodhimin dhe shpërndarjen e filmit dhe që kanë vlera cilësore dhe interes kulturor kombëtar, gjithashtu raporton për realizimin e projekteve dhe fondeve të miratuara. Neni 5, Funksionet: pika 1. Kryetari i QKK është përfaqësuesi i institucionit në marrëdhëniet me të tretë. Ai përcakton dhe drejton strukturën administrative të QKK. 2. Drejton veprimtarinë e QKK në përputhje me kërkesat e ligjit 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë” dhe të këtij statuti”.*

Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe Funksionimit të QKK me nr. 163, datë 22.05.2024, ka të përcaktuar ndër të tjera se: *“Kreu 2, pika B.2.1. Kryetari është organi drejtues i QKK, që emërohet nga Këshilli i Ministrave dhe kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:*

1. Kryetari ka kompetenca të plota për të vepruar në dhe për llogari të QKK-së, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi;

2. Kompetencat e Kryetarit përfshijnë, por nuk kufizohen si më poshtë:

- Të kryejë të gjitha veprimet për drejtimin e QKK-së.*
- Nxjerr urdhra të brendshëm me qëllim përmbushjen e funksioneve të njohura nga ligji dhe Statuti i QKK-së.*
- Merr vendime që lidhen me çështje organizative apo financiare, sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.*
- Emëron Komisionet dhe Këshillat që ushtrojnë aktivitetin në QKK.”.*

Në zbatim të kompetencave ligjore të parashikuara si më sipër, Kryetari i QKK-së ka miratuar “Rregulloren e Përgjithshme të Mbështetjes Financiare dhe Lejeve”, me nr. 168, datë 27.05.2024.

Në Kreun III, pika I.1 dhe 2, të kësaj rregulloreje përcaktohet se: “Detyrat kryesore të QKK janë por nuk kufizohen: 1. Përcakton shpërndarjen e fondit buxhetor për gjininë e filmit (artistik, dokumentar e të animuar). 2. Shpërndan fondin për projektet që përmbushin kërkesat e rregullores për produksionin dhe shpërndarjen e filmit dhe që kanë vlerë cilësore dhe interes kulturor kombëtar, gjithashtu raporton për realizimin e projekteve dhe fondeve të miratuara”.

Në Kreun V, pika III, të Rregullores është përcaktuar se: “2. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve do të skualifikojë projektet që nuk paraqesin (ngarkojnë në sistem) të gjithë dokumentacionin e përcaktuar “I detyrueshëm”, apo që paraqesin (ngarkojnë në sistem) dokumente të pavlefshme. 4. Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve (KSHPP), konform procedurës me të cilën operon, vendos për projektet që janë paraqitur në mënyrë korrekte, të cilët do të kalohen për shqyrtim në KPL apo KMP. 5. Projekte që evidentohen me mangësi në dokumentacion, do ti rikthehen për plotësim/korrigjim aplikuesit brenda afatit të përcaktuar nga KSHPP. 6. Projekti do të skualifikohet në rast se producenti nuk paraqet dokumentacionin e plotësuar/korrigjuar brenda afatit të caktuar nga KSHPP. Argumentimi i KSHPP për arsyet e skualifikimit, i përcillet producentit nga specialisti i projekteve. 8. Për projektet e shpallura fituese nga KMP-të, producenti duhet të dorëzojë dokumentacionin origjinal pranë Drejtorisë së Projekteve të QKK përpara nënshkrimit të kontratës së financimit”.

Në Kreun V, të Rregullores përcaktohen kriteret e detyrueshme për kualifikimin në konkurrim, si më poshtë:

1. Projekte për film artistik me metrazh të gjatë:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.*
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën tre kontrata financimi të suksesshme me QKK, dy prej të cilave të jenë filma artistikë metrazh të gjatë - vepër e parë dhe vepër e dytë.*
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.*
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë realizuar të paktën tre filma, nga të cilët dy filma me metrazh të gjatë - vepër e parë dhe vepër e dytë, me financimin e QKK ose me fonde publike organizmave të huaja homologe të QKK.*

2. Projekte për film artistik me metrazh të gjatë – Vepër e parë dhe e dytë:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.*
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy vepra filmike, nga të cilët njëra me financimin e QKK.*
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.*
- d. Regjisori i projektit me metrazh të gjatë - vepër e parë dhe e dytë, duhet të ketë:*

- i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi në institucionet e arsimit të lartë brenda ose jashtë vendit.
- ii. realizuar më parë të paktën dy filma artistikë me metrazh të gjatë/të shkurtër/film dokumentar të financuar nga QKK ose me fonde publike organizmave të huaja homologe të QKK.
- iii. punuar së paku në dy filma apo produkte audiovizuale të mbështetura financiarisht nga QKK pas studimeve.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën d (më sipër) duhet të ketë realizuar një film artistik me metrazh të gjatë (me fonde të pavarura), i cili është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreu II/ A.1.2, nënpike 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.

3. Projekte për film artistik me metrazh të shkurtër:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik, ose person fizik shqiptar.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit.....
 - ii. punuar së paku në dy filma si asistent pas studimeve.
- d. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën c më sipër duhet të ketë realizuar një film artistik me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreu II/ A.1.2, nënpike 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.

4. Projekte për film dokumentar:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik, ose person fizik shqiptar.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit.....
 - ii. punuar së paku në dy filma si asistent pas studimeve.
- d. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën c më sipër duhet të ketë realizuar një film dokumentar me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e mirënjohura të filmit dokumentar në botë dhe Evropë.

5. Projekte për film të animuar:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar në rastin e filmit të animuar me metrazh të mesëm ose të gjatë, ose person fizik shqiptar në rastin e filmit të animuar me metrazh të shkurtër.
- b. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë:

- i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia brenda ose jashtë vendit. Të diplomuarit jashtë vendit, duhet të paraqesin diplomën e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, konform procedurave ligjore në fuqi.
- ii. punuar së paku në dy filma të animuar si asistent pas studimeve.
- d. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën c më sipër duhet të ketë realizuar një film të animuar me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreun II/A.1.2, nënpika 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.

6. Projekte për postproduksion dhe distribucion:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik.
- b. Producenti duhet të ketë prodhuar së paku dy filma nga të cilët njëri me financimin e QKK.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit....
 - ii. punuar së paku në dy filma si asistent pas studimeve.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën d më sipër duhet të ketë realizuar një film me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreun II/A.1.2, nënpika 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK.
- f. Producenti nuk duhet të ketë marrë mbështetje financiare nga QKK, për projektin me cilin aplikon për postproduksion dhe distribucion.

7. Projekte për vepra audiovizuale:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy vepra filmike, nga të cilët njëra me financimin e QKK.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi brenda ose jashtë vendit.....
 - ii. punuar së paku në dy filma si asistent pas studimeve.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën d më sipër duhet të ketë realizuar së paku një serial, me fonde të pavarura të cilët janë difuzuar në rrjete televizive kombetare, platforma me ose pa pagesë dhe platforma të tjera të dedikuara.

8. Projekte të ndryshme kinematografike:

- a. b. c. d. Drejtuesi i projektit duhet të ketë: i. Përfunduar studimet e larta brenda ose jashtë vendit. ii. Punuar së paku në dy projekte të ngjashme brenda ose jashtë vendit. e. f.

9. Projekte për koproduksion në pakicë (Minority coproduction)

- a. Producenti aplikues duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti shqiptar, duhet të ketë përmbyllur të paktën 2 (dy) filma artistikë me metrazh të gjatë, njërin prej të cilëve me financim nga QKK.
- c. d. e. f. ”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga palët, rezulton se në Rregulloren e QKK-së, të miratuar nga Kryetari i QKK, me nr. 57, datë 27.01.2023, kriteret e detyrueshme për kualifikim në konkurrim kanë qenë si më poshtë:

1. Projekte për film artistik me metrazh të gjatë karriere:

- a. b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy kontrata financimi të suksesshme me Qendrën, një prej të cilave të jetë film artistik metrazh të gjatë - vepër e parë.
- c. d. Regjisori i projektit duhet të ketë realizuar të paktën dy filma, nga të cilët një film me metrazh të gjatë - vepër e parë me financimin e Qendrës.

2. Projekte për film artistik me metrazh të gjatë – Vepër e parë:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.
- b. Producenti duhet të ketë realizuar të paktën dy vepra filmike, nga të cilët një vepër filmike të jetë realizuar me financimin e Qendrës.
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit me metrazh të gjatë - vepër e parë, duhet të ketë:
 - i. përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi në universitetet brenda ose jashtë vendit, që kanë realizuar një film artistik me metrazh të gjatë me fonde të pavarura.
 - ii. realizuar më parë të paktën një film artistikë me metrazh të shkurtër/film dokumentar të financuar nga Qendra.
- e. Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën d (më sipër) duhet të ketë realizuar një film artistik me metrazh të gjatë (me fonde të pavarura), i cili është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kapitullin IV, Seksioni I/E, nënpika 10 të kësaj Rregullore.

3. Projekte për film artistik me metrash të shkurtër:

- a. Producenti duhet të jetë subjekt juridik, ose person fizik shqiptar.
- b. Producenti nuk mund të jetë: i. Skenarist/Bashkëskenarist i projektit; ii. Regjisor /Bashkëregjisor i projektit;
- c. Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.
- d. Regjisori i projektit duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor/Master për Regji Filmi në një nga universitetet brenda ose jashtë vendit.....

- e. *Regjisori, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në pikën d më sipër duhet të ketë realizuar një film artistik me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kapitullin IV, Seksioni I/E, nënpika 10 të kësaj Rregullore.*

4. Projekt për film dokumentar:

- a. *Producenti mund të jetë subjekt juridik, ose subjekt fizik shqiptar.*
b. *Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.*

5. Projekte për film të animuar:

- a. *Producenti mund të jetë subjekt juridik, ose subjekt fizik shqiptar.*
b. *Regjisori i projektit duhet të ketë shtetësi shqiptare.*

6. Projekte për Minority co-production:

- a. *Producenti aplikues duhet të jetë subjekt juridik shqiptar.*
b. *Producenti shqiptar, duhet të ketë realizuar të paktën një kontratë të suksesshme për film artistik të financuar nga Qendra.*
c. d. e. ”.

Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve, në datë 06.12.2024, ka marrë në shqyrtim dokumentacionet për projektet e dorëzuara sipas kategorive të konkurimit.

Referuar Procesverbalit nr. 437/7, datë 06.12.2024, rezulton se KSHPP, ka shqyrtuar dokumentacionin e projekteve të dorëzuara për Filma të Animuar. Në këtë kategori kanë konkuruar dy projekte: 1. Projekti: “Këpucët” me Skenar: E.S, Regjia: B.Sh/As. Regji F.A dhe Producent J.K; dhe 2. Projekti: “Legjenda e Vlamaleve” me Skenar, Regji dhe Producent: E.Th.

Në përfundim KSHPP ka vendosur të kualifikojë për shqyrtim automatik në Komisionin e Miratimit të Projekteve, projektin: “Këpucët” dhe të kthejë për plotësim projektin: “Legjenda e Vlamaleve” për arsye të mosplotësimit të kriterit të përfundimit të studimeve Bachelor/Master për Regji Filmi ose Arte Figurative dhe Multimedia, të regjisoresh E.Th.

Duke analizuar sa më sipër, Komisioneri konstaton se kriteri i detyrueshëm për regjisorët, për diplomën për Regji Filmi, ka qenë i parashikuar në Rregulloren e vitit 2023 për disa kategori të projekteve (film artistik me metrazh të gjatë dhe film artistik me metrazh të shkurtër) dhe në rregulloren e vitit 2024 është shtuar si kriter i detyrueshëm për regjisorët dhe për kategoritë e projekteve për Film Dokumentar, Film të Animuar, Projekte për Postproduction dhe Distribucion dhe Projekte për Vepra Audiovizuale dhe se vendosja e këtij kriteri nuk penalizon ndonjë kategori regjisorësh për shkak të moshës apo fillimit të studimeve, pasi nga viti 2009 deri në vitin 2024, (rreth 15 vite) persona të ndryshëm mund të ndiqnin studimet në degën e studimit për regji filmi.

Për më tepër që në rregullore është e parashikuar se nëse regjisori nuk zotëron diplomë për regji filmi duhet të përmbushë kriterin tjetër, që të ketë realizuar një film të animuar me fonde të pavarura, që është kualifikuar në konkurim zyrtar në një nga festivalet e përcaktuara në Kreun II/A.1.2, nënpika 11 të Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të QKK. *Pra, regjisorët që nuk janë të diplomuar për regji filmi, nuk janë të skualifikuar automatikisht, por kanë dhe një mundësi tjetër për tu kualifikuar me projektin e tyre.*

Në vlerësim të Rregulloreve të vitit 2023 dhe 2024, rezulton se QKK, përveç të tjerash ka shtuar dhe kriterin e diplomës për Regji Filmi, jo vetëm për regjisorët që konkurojnë në kategorinë e projekteve për Film të Animuar, ku konkuronte ankuesja, por dhe për regjisorët që konkurojnë në kategoritë për projekte për Film Dokumentar, projekte për Postproduction dhe Distribucion dhe projekte për Vepra Audiovizuale.

Rezulton se KSHPP, me Procesverbalin nr. 437/4, datë 06.12.2024, ka kthyer për plotësim dhe dy projekte të tjera që nuk plotësonin kriteret e detyrueshme, në kategorinë e Filmave me Metrazh të Shkurtër, për arsye se nuk plotësonin kriterin e diplomës: 1. Projektin “Sharlota” me Skenar z. Y.A, Regji znj. A.D dhe Producent znj. E.G, për arsye se regjisorja znj. A.D ka vërtetim diplomimi në degën Skenar, pra nuk ka paraqitur dokumentin për studime: Profil Regji dhe 2. Projektin “Si ujë” me Skenar z. R.H, Regji z. I.M dhe Producent z. K.P, sepse regjisori z. I.M, ka diplomë për regji në Fakultetin e Artit Skenik.

Gjithashtu, rezulton se KSHPP, me Procesverbalin nr. 437/5, datë 06.12.2024, ka kthyer për plotësim dhe një projekt që nuk plotëson kriteret e detyrueshme, në kategorinë e Filma Artistikë me Dokumentar, Projekti “Një princeshë Europiane”, me Skenar z. M.C, Regji z. Y.P dhe Producent znj. A.D, për arsye se në dosje ka munguar diploma e regjisorit z. Y.P.

Pra referuar më sipër, QKK nëpërmjet vendosjes së kriterit të diplomës, nuk ka kualifikuar për konkurim, jo vetëm ankuesen, por dhe regjisorë të tjerë në kategori të ndryshme të projekteve të cilët nuk plotësonin kriterin e diplomës.

QKK ka informuar se kriteri i arsimimit (diplomës) është vendosur për të garantuar cilësinë dhe profesionalizmin e projekteve të financuara nga QKK-ja, pasi filmat e animuar kërkojnë njohuri specifike teknike dhe artistike dhe se vendosja e këtij kriteri garanton që projektet e financuara nga QKK të jenë në nivelin e duhur profesional dhe artistik, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe përdorim eficient të fondeve shtetërore.

Lidhur me arsyetimin e mësipërm të dhënë nga QKK, Komisioneri vlerëson se për shkak të natyrës së këtij aktiviteti profesional dhe artistik, nuk zotëron ekspertizën e nevojshme për të vlerësuar nevojat teknike dhe artistike të vendosjes së këtij kriteri nga ana e QKK, por vlerëson se bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, QKK-ja ka kompetencën dhe ekspertizën e duhur për të vlerësuar vendosjen apo heqjen e kritereve të ndryshme për vlerësimin e projekteve kinematografike.

Nga informacioni i administruar nga palët gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se Universiteti i Arteve ka diplomuar studentë në degën Regji Filmi, që në vitin 2009, ndërkohë që ankuesja ka filluar studimet Master në vitin 2011 dhe është diplomuar në degën Regji Teatri dhe Spektakli në vitin 2013. Pra, ankuesja ka filluar studimet master në periudhën kur Universiteti i Arteve ka pasur të hapur degën për regji filmi.

- *Lidhur me pretendimin e ankueses se dhe z. E.T nuk dorëzoi një prej dokumenteve të detyrueshme (diplomës) dhe u shpall fitues.*

Referuar procesverbalit nr. 437/8, datë 06.12.2024 të KSHPP, rezulton se producenti E.T ka konkuruar në kategorinë e projekteve Post Production dhe Distribution dhe është kualifikuar për konkurim me shënimin: *“Në rast se shpallet fitues nga Komisioni i Miratimit të Projekteve, duhet të dorëzohet në QKK, diplomën e regjisorit, para firmosjes së kontratës”.*

Lidhur me këtë pretendim, përfaqësuesja e QKK, gjatë seancës dëgjimore deklaroi se z. E.T ka sjellë vërtetim nga ministria përkatëse, sepse i përket një brezi që janë djegur regjistrat.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, kriteri për diplomë në regji filmi ose arte figurative dhe multimedia, i vendosur nga QKK-ja, për regjizorët që aplikojnë për projekte të ndryshme kinematografike, nuk duket subjektiv dhe lidhet ngushtësisht me sa kërkohet dhe përcaktohet në rregullore. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se situata përjashtuese në të cilën është vendosur ankuesja si pasojë e skualifikimit të saj për shkak se nuk kishte diplomë për regji filmi ose arte figurative dhe multimedia, është në mënyrë objektive e justifikuar, pasi lidhet me kërkesën e QKK-së, për kualifikimin e regjizorëve për të siguruar cilësinë e projekteve.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pabarabartë, nga ana e QKK-së, pasi, vendosja e kriterëve për vlerësimin e projekteve kinematografike, është në kopetencën dhe diskrecionin e institucionit dhe se gjatë vlerësimit të projekteve Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve nuk ka kualifikuar dhe kandidatë të tjerë që kanë konkuruar në kategori të ndryshme të projekteve kinematografike për arsye të mosplotësimit të kriterit të diplomës.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në nenin 20/1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura*

në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit, si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e Qendrës Kombëtare Kinematografike.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Qendrës Kombëtare Kinematografike, për shkakun e pretenduar nga ankuesja dhe për rrjedhojë nuk provohet se Qendra Kombëtare Kinematografike, ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. E.Th nga ana e Qendrës Kombëtare Kinematografike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA